# DËSHMI ARKIVI

**A-443319**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vendimi më 16 shtator - Mark Rutte: KFOR-i është aty pavarësisht aktgjykimit në Hagë për ish-krerët e UÇK! |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/rajoni/vendimi-me-16-shtator-mark-rutte-kfor-i-eshte-aty-pavaresisht-aktgjykimit-i586049` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | deleted |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 13:54:29 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 15:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `54271d2078daa335be95388b2d5a5758d18d16f5ebfb7939b1f1342971c7b3e4` |
| TEKSTI | `50994f969427b8e20b4c1f630831ff9f41283c1c46fe66c069e8f8f1e53e19e0` |
| PAMJA | `a1a0c30a2a29b99734124a6e971a0c9b8cd8d9e0ba23f6908b6ceb9a22c1a6c5` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2b0a76051962de8baf4e8f278d95b5f423b8f2734da6f0533c0e06de155085e2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `6e410cf6c3be6bd40f75161c1288a8066fcd1b6e7ab80a3c789507dd842f2954` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2b0a76051962de8baf4e8f278d95b5f423b8f2734da6f0533c0e06de155085e2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Vendimi më 16 shtator - Mark Rutte: KFOR-i është aty pavarësisht aktgjykimit në Hagë për ish-krerët e UÇK!


TemA
14 Shtator 2026, 17:30Rajoni TEMA




Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka deklaruar se përkushtimi i Aleancës për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë do të mbetet i pandryshuar, pavarësisht zhvillimeve të mundshme pas shpalljes së aktgjykimit ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë pritet të shpallin më 16 shtator aktgjykimin ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, si dhe ish-deputetit Rexhep Selimi, në çështjen ku akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të katër janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha dhjetë pikat e aktakuzës.

Rutte tha se KFOR-i ndodhet në Kosovë për të kontribuar në ruajtjen e stabilitetit dhe paqes, ndërsa misioni paqeruajtës i NATO-s, sipas tij, ka luajtur rol për më shumë se dy dekada në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Deklarata e tij erdhi në përgjigje të pyetjes nëse NATO është e shqetësuar për mundësinë e trazirave të dhunshme në Kosovë dhe rajon, në varësi të vendimit që do të shpallet në Hagë.

Shefi i NATO-s theksoi se Aleanca do të vazhdojë të vlerësojë përbërjen dhe vendosjen e trupave të KFOR-it, në mënyrë që misioni të përshtatet me situatën e sigurisë në Kosovë.

Ai nënvizoi gjithashtu se zhvillimet në Kosovë kanë ndikim edhe në stabilitetin e rajonit më të gjerë.

Deklaratat e Ruttes vijnë disa orë pasi Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë u bëri thirrje shtetasve amerikanë që të shmangin lëvizjet pranë vendeve ku, sipas saj, janë paralajmëruar protesta më 16 shtator./REL/

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[SHBA-ja paralajmëron Serbinë për afrimin me Kinën në fushën e IA-së]

14:20 Rajoni / 1 koment

[Verdikti që po mban Kosovën në ankth, çfarë presin qytetarët më 16 shtator]

12:20 Rajoni

[Kosovë/ PDK çon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit, paralajmëron edhe kërkesë për Qeverinë Kurti 4]

09:52 Rajoni / 1 koment

Kurti 4 pa urime: Këtë herë mungoi edhe Sali Berisha


22:50 Rajoni / 25 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.